

Korrigjim nr. 2 i Udhëzuesit për Aplikues për masën 101

- a) Paragrafi i fundit i kapitullit 4.1 Sektori i pemëve (faqe 10) i Udhëzuesit për Aplikues për M-101 që ka të bëjë me kriteret specifike për sektorë:

Projektet e nën masës së pemëve manore, duhet që të përfshijnë ndërtimin e depos ftohëse dhe atë: projektet me sipërfaqe ≥ 0.50 ha - < 1 ha duhet të ndërtojnë depo me kapacitet së paku 10 t, ndërsa projektet me sipërfaqe ≥ 1 ha - ≤ 2 ha duhet të ndërtojnë depo me kapacitet së paku 20 t.

Korrigjohet si në vijim:

Projektet e nën masës së pemëve manore, **vetëm ne rastin e mjedrave**, duhet që të përfshijnë ndërtimin e depos ftohëse dhe atë: projektet me sipërfaqe ≥ 0.50 ha - < 1 ha duhet të ndërtojnë depo me kapacitet së paku 10 t, ndërsa projektet me sipërfaqe ≥ 1 ha - ≤ 2 ha duhet të ndërtojnë depo me kapacitet së paku 20 t.

- b) Dispozitë shtesë, sqaruese:

Në rast të mbjelljes së boronicave në vazo, vlen kriteri i njëjtë i pranueshmerisë për sipërfaqe minimale prej 0,5 hektar në të cilën duhet të mbillen së paku 1500 fidanë. Për të plotësuar kriterin e sipërfaqes mbi një hektar, duhet të mbillen mbi 3000 fidanë në vazo!